



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568  
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

## DEKLARATË PËR SHTYP

### Mbi ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë dhe në tregun valutor

Në kuadër të transparencës me publikun, Banka e Shqipërisë njofton ndërhyrjet e saj në tregun e parasë dhe në tregun valutor. Në mbështetje të Rregullores së Transparencës së Bankës së Shqipërisë dhe në përputhje me Kodin e Praktikave të Mira për Transparencën në Politika Monetare dhe Financiare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, njoftimi për këto ndërhyrje publikohet 3 muaj pas kryerjes së veprimeve.

#### 1. Ndërhyrjet në tregun e parasë

##### 1.1 Operacionet e tregut të hapur.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2003, situata e likuiditetit në sistemin bankar është karakterizuar nga tepriçë likuiditeti. Për të balancuar efektin pozitiv të faktorëve autonom në rezervat e tepërta, Banka e Shqipërisë përdori të gjitha instrumentet indirekte të disponueshme përfshirë repo njëjavore, repo njëmujore, repo tremujore si dhe transaksionet e shitjes me të drejta të plota nga portofoli i bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë.

Efkti i përhershëm i thithjes së likuiditeteve nëpërmjet shitjes me të drejta të plota të bonove të thesarit u materializua në vlerën 3.4 miliardë lekë, ndërsa për sa i përket instrumenteve të marrëveshjeve të riblerjes, efekti mesatar ditor ishte respektivisht 3,3 miliardë lekë të tërhequra me repo njëjavore, 3,2 miliardë lekë të tërhequra me repo njëmujore dhe 1 miliard lekë të tërhequra me repo tremujore duke filluar nga data 15 maj 2003.

Tabela e mëposhtme paraqet vëllimet (në milionë lekë) e likuiditetit të tërhequra nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur.

Data	REPO javore	REPO mujore	REPO tremujore	Shitje me të drejta të plota
03-04-03	3,350			
10-04-03	2,488	2,158		


17-04-03	1,420			
24-04-03	3,275			
02-05-03	3,625	1,205		
08-05-03	7,605	210		
15-05-03	2,770	2,188	1,000	
22-05-03	4,100	170		
29-05-03	3,400	2,000		
05-06-03	3,348	100		1,437
12-06-03	3,275			1,962
19-06-03	2,013			
26-06-03	3,465	2,000		

## 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Në mbështetje të instrumenteve të tregut të hapur, bankat kanë përdorur depozitën njëditore për investimin e likuiditeteve të lira, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 665 milionë lekë. Gjendja e tepricës së likuiditetit të sistemit bankar bëri që kërkesa e bankave për kredi njëditore të ishte shumë e ulët, mesatarisht 16 milionë lekë në ditë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë për tremujorin e dytë të vitit 2003.

Ulja e nivelit shkaktohet nga tërheqja e përhershme e likuiditetit me anë të transaksioneve outright



## **1.2. Ndërrhyrjet në tregun e brendshëm valutor.**

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të jetë e pranishme në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë, me përjashtim të muajit prill. Veprimet e realizuara me bankat e nivelit të dytë, sikurse dhe në periudhën paraardhëse, përfaqësojnë veprime të blerjes në valutë, me të vetmin ndryshim se gjatë kësaj periudhe të fundit, blerjet në dollarë amerikanë dhe ato në euro kanë qenë thuajse të ekuilibruara. Kështu në një vëllim total të blerjeve prej 11 325 890 usdd, 50.73 për qind përfaqësojnë veprime të kryera në monedhën e përbashkët evropiane. Vëllimi i operacioneve të realizuara në kuadrin e ndërhyrjes aktive është rreth 60 për qind më i ulët krahasuar me periudhën janar-mars, ku vëllimi i blerjeve me bankat e nivelit të dytë ishte 28 337 740 usd.